

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

# PROJEKTI

**“HISTORIA E SHQIPTARËVE GJATË  
SHEKULLIT XX”**

Autorë

Prof. Dr. Muharrem Dezhgiu

Akademik Beqir Meta

Tiranë, Qershor 2015

# Hyrje

Projekti “**HISTORIA E SHQIPTARËVE GJATË SHEKULLIT XX**” është nisur në kuadër të Programit Kombëtar të Kërkimit dhe të Zhvillimit, drejtimi Shkencat Sociale. Kontrata mes institucionit zbatues, Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike (QSA), dhe organizmit financues, Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI), është lidhur në korrik të vitit 2010. Financimi i Projektit ka vijuar deri në vitin 2014.

## 1. "HISTORIA E SHQIPTARËVE GJATË SHEKULLIT XX" dhe botimet e tjera akademike të mëparshme në llojin e saj

Projekti "HISTORIA E SHQIPTARËVE GJATË SHEKULLIT XX" është një studim sintetik akademik për historinë tonë kombëtare përgjatë shekullit XX.

Në gjithë periudhën e tranzicionit postkomunist deri më sot nuk ka patur një botim të mirëfilltë akademik të këtij lloji, i cili të bazohet dhe të pasqyrojë referencat burimore dhe të japë pikëpamjet kundërthënëse për tezat kryesore historiografike që janë të debatueshme. Kështu që për këtë arsye një botim i këtij karakteri ishte i domosdoshëm dhe i dobishëm.

I vetmi botim që është disi i ngjashëm është teksti "Historia e Popullit Shqiptar" vëll.III, Periudha e Pavarësisë, 28 nëntor 1912 – 7 prill 1939, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimet Toena, Tiranë 2007, 600 faqe; "Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi i IV (1939-1992), Botimet Toena, Tirane, 2008, 455 faqe.) Ky botim i mëparshme nuk ka dy karakteristikat e lartpërmendura, por gjithashtu ai përmban edhe një sërë problemesh e të metash të cilat janë vënë në dukje në recensat që i janë bërë atij, si dhe në këshillin shkencor të Institutit të Historisë:

**Së pari:** Pjesët kryesore të atij botimi janë hartuar nga autorë që nuk kishin kontestuar më parë pikëpamjet e historiografisë komuniste për çështje thelbësore të periudhës historike në fjalë.

**Së dyti:** Metodatat e studimit dhe shkrimit të tij nuk janë shkëputur tërësisht nga metodat e mëparshme tendencioze e të njëanëshme në analizën dhe vlerësimin e ngjarjeve historike.

**Së treti:** Nuk ishin shfrytëzuar dhe nuk ishin marrë në konsideratë shume vepra të rëndësishme historiografike shqiptare që janë botuar gjatë periudhës postkomuniste, dhe ishte mbajtur një qëndrim injorues ndaj shumë pikëpamjeve të reja që ata kanë parashtruar.

Gjithashtu nuk ishin marrë në konsideratë as disa botime thelbësore të huaja, veçanërisht nga autorë perëndimorë, të realizuara para dhe pas vitit 1990.

**Së katërti:** Disa autorë të pjesëve themelore të atij botimeve nuk kishin bërë kërkime të reja në materialet burimore, arkivore apo bibliografike për probleme që kërkonin hulumtime të reja dhe rivlerësime të materialit burimor të grumbulluar më parë, për arsye të metodave tendencioze e të njëanshme që kanë qenë aplikuar para vitit 1990 në vjeljen dhe analizën e burimeve historike.

**Së pesti:** Gjuha e teksteve në ndonjë rast nuk ishte korrekte dhe kishte stil të vjeter, gjë që duhej kapërcyer.

**Së gjashti:** Terminologjia në shumicën e rasteve ishte e vjetëruar dhe reflektonte mendësinë e së kaluarës.

Pikërisht kjo gjendje ishte një arsye themelore më tepër për t'i hyrë punës për shkrimin e një historie të re të shqiptarëve për shekullin e XX.

## **Momenti historik dhe nevoja për Projektin “HISTORIA E SHQIPTARËVE GJATË SHEKULLIT XX”**


Çdo komb e shkruan dhe rishkruan vazhdimisht historinë e vet kombëtare. Kjo bëhet e nevojshme për shkak të zbulimit të burimeve të reja historike, i cili është një proces i pashtershëm, si rezultat i avancimit të metodave shkencore në fushën e historiografisë dhe ato të shkencave sociale në përgjithësi, si dhe nga ndryshimet që ndodhin në botëkuptimin e brezave dhe në mënyrën sesi ato e perceptojnë të kaluarën e tyre.

Për Shqipërinë realizimi i projekteve të tilla është një domosdoshmëri edhe më imperative për këto arsye:

- a. Për shkak të politizimit të tejskajshëm të historisë sonë kombëtare, veçanërisht të asaj të shekullit XX nga diktatura komuniste, çka është një fakt tashmë i pranuar përgjithësisht. Pasojat e këtij politizimi janë të thella në historiografi dhe duhet bërë shumë punë për tejkalimin e tyre. Kërkimet shkencore dhe veçanërisht në burimet arkivore janë kushti esencial për realizimin e këtij objekti madhor shkencor.
- b. Për shkak të mos hapjes për shfrytëzim të arkivave vendase.
- c. Për shkak të mungesës së kërkimeve në arkivat e huaja, si pasojë e mungesës së financimeve.
- d. Si rezultat i evoluimit e thellimit dinamik të studimeve historike të veçanta, rezultatet e të cilave duhet të integrohen në vepra sintetike akademike.
- e. Si rezultat i përmirësimit të metodave shkencore historiografike dhe evoluimit të koncepteve shkencore mbi historinë tonë kombëtare, të cilat janë procese që po ecin me shpejtësi.

## 2. Projekti ka shënuar disa arritje të rëndësishme në raport me projektet e mëparshme

- Ka avancuar metodat shkencore-kërkimore, duke rritur dukshëm shkallën e objektivitetit shkencor në shkrimin e historisë. Metodatat e përdorura janë: historicizmi; objektiviteti shkencor; metoda krahasuese, metoda analitike historike, metoda sintetike historike.
- Metoda kryesore ka qenë verifikimi dokumentar i tezave historiografike, duke u bazuar mbi një bazë tepër të gjerë dokumentare, e paaplikuar deri më sot.
- Saktësia e rezultateve të arritura matet me kohezionin logjik të veprës, i cili shkon në përputhshmëri të plotë dhe është i verifikueshëm nga një gamë jashtëzakonisht e gjerë burimesh autentike.
- Projekti është bazuar në kërkime të gjera dhe substanciale në burimet arkivore vendase e të huaja, duke sjellë një revolucion të vërtetë në këtë drejtim në raport me kërkimet e realizuara në kuadrin e projekteve të mëparshme. Përveç arkivave vendase, pika më e fortë e këtij projekti janë hulumtimet në arkivat e huaja, duke sjellë në Arkivin e Institutit të Historisë 676.362 kopje dokumentesh, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me historinë e shqiptarëve në shekullin e XX. Kështu u zgjerua disafish baza burimore në raport me botimet e viteve 2007 e 2008, duke kapërcyer njëanshmërinë në bazueshmërinë burimore të veprës së asaj kohe

- 
- Në këtë proces kërkimor u përfshinë 38 studiues, përveç kërkimeve në arkivat shqiptare, u realizuan 1500 ditë kërkime në arkivat e huaja dhe u sollën në arkivin e Institutit të Historisë 676.362 faqe dokumente. Gjej rastin të falënderoj të gjithë studiuesit që u angazhuan në këtë proces kërkimor gjigant dhe sakrifikuan që prej tij të arriheshin rezultate sa më të mira.

Gjithashtu mirënjohja jonë shkon për qeverinë shqiptare dhe për Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, që besuan dhe mbështetën këtë projekt shkencor.

- Ky proces kërkimor ka përfshirë numrin më të madh të studiuesve që është angazhuar ndonjëherë. Për herë të parë u përfshinë edhe studentë të doktoraturës, si dhe kolegë nga Kosova e Maqedonia. Koha e kërkimeve, si dhe vëllimi i materialeve të hulumtuara janë më të mëdhatë të realizuara deri më sot.



- U zhvilluan kërkime të plota sistematike në katër arkiva të mëdha: Arkivat Kombëtare Britanike, i cili ka fondet e institucioneve shtetërore e jo shtetërore, prej të cilit janë marrë 126.056 kopje dokumentesh dhe tre të tjerët janë Arkiva Diplomatike, d.m.th. të Ministrive të Punëve të Jashtme. Nga dy prej tyre, ai i Francës dhe Gjermanisë janë marrë komplet koleksionet që kanë të bëjnë me historinë e shqiptarëve nga fillimi i vitit 1912 deri në vitet 1970-1980, kur këto arkiva ishin të hapura. Në secilin prej tyre u morën përkatësisht nga 61.472 dhe 54.955 kopje dokumentesh. Në Arkivin e MPJ Romë është marrë koleksioni më i madh deri tani, prej 375.053 kopjesh. Ky është arkivi më i madh për nga vëllimi i dokumentacionit historik që lidhet me historinë e shqiptarëve. Hulumtimet në inventarët dhe regjistrat e këtij arkivi janë bërë në mënyrë sistematike e tërësore. Informacioni i vjelë prej tyre është voluminoz dhe shumë i rëndësishëm.

- Një kategori tjetër arkivash janë shfrytëzuar pjesërisht për shkak të mundësive financiare që kishim në projekt. Hulumtime të gjera por jo të plota dhe sistematike janë kryer në Arkivat Kombëtare të Shteteve të Bashkuara, në Arkivin Qendror të Shtetit në Romë, në Arkivin e Vatikanit, Romë, në Arkivin Osman të Kryeministrisë, Stamboll, në Arkivin e MPJ të Bullgarisë, në Arkivin Shtetëror të Kroacisë, në Arkivin Shtetëror të Malit të Zi (Cetinë) dhe në Arkivin e Podgoricës, në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë. Sipas shteteve veçojmë Arkivat e Shteteve të Bashkuara prej të cilave janë marrë 28. 212 faqe dokumente, Arkivi i Maqedonisë me 13.509 faqe dokumente, Arkivat e Turqisë me 11.529 faqe dokumente dhe me më pak dokumente renditen arkivat e Malit të Zi, Bullgarisë, Greqisë, Kosovës, Zagrebit.
- Për herë të parë në Arkivat kryesore evropiane, si: Arkivat Kombëtare Britanike, Arkivi i MPJ të Francës, Arkivi i MPJ të Italisë dhe Arkivi i MPJ të Gjermanisë, dokumentet për historinë tonë kombëtare janë marrë në mënyrë të plotë, pra komplete. Në të ardhmen kjo metodë hulumtimi do të shtrihet edhe në arkivat e tjera, në përputhje me mundësitë e shfrytëzimit që krijojnë ato, shkallën e rëndësisë që paraqet dokumentacioni i tyre për historinë e shqiptarëve dhe sigurisht burimet financiare që do të sigurohen.

- Si rezultat i këtyre hulumtimeve të gjera dhe masive në studimin e ri janë arritur një sërë rezultatesh të rëndësishme. Janë sjellë argumente të reja shkencore për shumë ngjarje dhe fenomene historike gjatë shekullit XX, të cilat kanë modeluar dhe ndryshuar edhe mjaft teza historiografike të mëparshme të cilat janë aq të shumta sa nuk mund t'i përmendim të gjitha në këtë paraqitje të shkurtër, por po japim disa prej tyre:
- Në këtë projekt trajtohen në mënyrë të plotë dhe sistematike të gjitha problemet e historisë sonë kombëtare prej vitit 1912 deri në vitin 1992. Fokusi kryesor i projektit kanë qenë problemet më të nxehta dhe më të debatueshme në historiografinë shqiptare.

Të tilla janë:

- Veprimtaria e Qeverisë së Vlorës, funksionimi i institucioneve politike gjatë funksionimit të saj;
- Situata e brendshme politike në Shqipëri në vitet 1914-1915, me theksin tek analiza e rebelimit në Shqipërinë e Mesme;

- Plotësim informacionesh për marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore, me theks në rivlerësimin e politikës austro-hungareze dhe italiane;
- Vlerësim më i thellë dhe i argumentuar i aktivitetit të Qeverisë së Durrësit 1918-1920, në kontekstin e interesave pragmatiste dhe mundësive që kishte kombi shqiptar në atë kohë;
- Rivlerësimi i thellë, duke ju referuar burimeve autentike shqiptare, britanike e italiane, për zhvillimet politike dhe ndërtimin e institucioneve në vitet 1920-1924. Rikonceptimi i kësaj periudhe në raport me historiografinë e mëparshme, duke u bazuar në konceptet institucionale e konstituente, dhe në nevojat imediate që qëndronin atëherë përpara kombit dhe shtetit shqiptar;
- Në këtë kontekst është vlerësuar edhe Revolucioni i Qershorit 1924;

- Rivlerësim, duke u bazuar në burime serioze dokumentare dhe të hulumtuara me imtësi e në detaje mbi politikën dhe karakterin e regjimit të A. Zogut, si dhe rezultatet e tij. Regjimi i tij është studiuar duke u krahasuar me mundësitë reale të shoqërisë shqiptare të asaj kohe, nevojave të procesit të shtetformimit, si dhe të natyrës së regjimeve politike në Ballkan dhe Evropë në atë kohë;
- Është rivlerësuar pushtimi italian, shkaqet e tij dhe qëndrimi i A.Zogut ndaj tij.
- Po kështu është thelluar më tej informacioni dhe analiza mbi qëndrimin e Fuqive të Mëdha dhe shteteve ballkanike kundrejt agresionit italian;
- Është bërë një analizë dhe pasqyrim më i dokumentuar, dhe mbi këtë bazë një rikonceptim i qëndrimit të forcave të ndryshme politike e ushtarake ndaj pushtimit e pushtuesit, si dhe raportet midis tyre gjatë gjithë luftës.
- Është thelluar dhe përmirësuar informacioni dhe konceptet për qëndrimin e Fuqive Antifashiste ndaj çështjes shqiptare gjatë Luftës;

- Mbi gjendjen e nacionalizmit shqiptar gjatë kësaj periudhe dhe mbi rezultatet e luftës në trojet shqiptare;
- Është thelluar analiza mbi karakteristikat e regjimit komunist në Shqipëri, duke bërë krahasime me regjimet komuniste me vendet e Lindjes;
- Mbi marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë, duke u fokusuar në specifikat e Shqipërisë që lidhen me izolimin e plotë ndërkombëtar, si dhe pasojat e tij;
- Janë sjellë informacione të reja për gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi dhe evoluimin e situatës politike, ekonomike dhe social-kulturore të tyre.
- Këto zhvillime janë dhënë të gërshetuara me ato brenda Shqipërisë politike; Janë evidentuar dhe dokumentuar shumë më bindshëm se më parë pasojat ekonomike, politike, sociale e kulturore të sundimit komunist në Shqipëri, duke u vlerësuar në mënyrë krahasuese me regjimet analoge në vendet e tjera.

- Ndryshe nga projektet e mëparshme në këtë studim përmenden tezat themelore historiografike të autorëve më në zë dhe origjinalë. Autorët e projektit kanë mbajtur ndaj tyre qëndrim afirmues ose kritik, duke u bazuar në argumentet e reja historiografike që ata sjellin, ose në metodat e reja analitike shkencore që kanë zbatuar. Janë shfrytëzuar dhe marrë në konsideratë tërësisht gjithë veprat e rëndësishme të shkruara në periudhën postkomuniste, duke siguruar gjithëpërfaqësimin e literaturës historike dhe duke shmangur injorimin që i ishte bërë një pjese të historiografisë së re dhe pikëpamjeve të reja shkencore. Kështu është kapërcyer një mangësi themelore e botimeve të viteve 2007 e 2008.
- Ndryshe nga botimet e mëparshme, në këtë projekt tezat e reja shoqërohen me referenca shkencore serioze dhe autentike. Është realizuar një botim i mirëfilltë akademik, i cili bazohet dhe pasqyron me gjerësi e thellësi të panjohur më parë referencat burimore.

- Në projektet e mëparshme ka pasur një përzgjedhje të autorëve duke u nisur nga afërsia e pikëpamjeve shkencore që ata kishin midis tyre. Në projektin tonë numri i autorëve është cilësisht më i madh dhe janë angazhuar të gjithë specialistët që kanë dashur të bashkëpunojnë, duke u nisur nga fusha e studimeve që ata janë profilizuar.
- Gjuha akademike e teksteve është përmirësuar në shumë raste.
- Disa terma të vjetëruar që reflektonin konceptet e së kaluarës janë zëvendësuar me terminologji të re, si ajo që aplikohet në historiografinë e përparuar perëndimore.
- Numri i autorëve që e shkruan këtë tekst është shumë më i madh se ai pjesëmarrës në botimin e mëparshëm, duke shmangur çdo tendencë përjashtuese. Përzgjedhja e tyre është bërë sipas kriterëve profesionale dhe të kontributit që ata kanë në studimin e problemeve të ndryshme të historisë sonë kombëtare.



# Organizmat shkencore bashkëpunuese të vendit dhe të huaja

Në këtë projekt bashkëpunuan studiues që punojnë në:

- Qendra e Studimeve Albanologjike,
- Fakulteti i Historisë, (UT)
- Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës
- Instituti Albanologjik (Prishtinë)
- Instituti i Historisë (Prishtinë)
- Instituti i Gjuhë-Letërsisë (Tiranë)
- Fakulteti i Shkencave Sociale, (UT)
- Universiteti European i Tiranës
- Universiteti i Prishtinës
- Universiteti i Tetovës
- Akademia Ushtarake Tiranë
- Arkivi i Maqedonisë -Shkup

# Personeli shkencor i projektit

- Ana Lalaj
- Ardian Marashi
- Abdulla Vokrri
- Beqir Meta
- Emine Bakalli
- Fatmira Musaj
- Fatmira Rama
- Gjergj Sinani
- Haki Kasumi
- Halim Purellku
- Esat Stavileci
- Jusuf Bajraktari
- Fehmi Rexhepi
- Hamit Kaba
- Hivzi Islami
- Pranvera Dibra
- Iljaz Gogaj
- Eriketa Kambo
- Musa Limani
- Muharrem Dezhgiu
- Marenglen Verli
- Marenglen Kasmi
- Sabile Basha
- Teodor Kareco
- Izber Hoti
- Muhamet Shatri
- Sokol Gjermani
- Sonila Boci
- Ksenofon krisafi
- Lush Culaj
- Ledia Dushku
- Limon Rushiti
- Qerim Lita
- Xheladin Shala
- Pranvera Dibra
- Musa Limani
- Esat Stavileci
- Sabile Basha
- Dritan Egro

## 3. Dobia publike e projektit dhe rekomandimet

### Periudha në të cilën u realizua projekti

- Projekti është realizuar në periudhën 2010-2015. Siç kemi shkruar edhe më parë, nuk është përfunduar ende për shkak të shtrirjes së financimit në shumë vite, përtej kohës së parashikuar në projektin origjinal.
- Gjithashtu volumi i kërkimeve në arkiva rezultoi shumë më i madh se sa ai i parashikuar prej nesh në fillim.
- Për këto arsye projekti do të përfundojë me botimin e tij në shqip në fund të vitit 2015, dhe në anglisht, në fund të këtij viti.

## • Aktivitetet shkencore realizuar në kuadrin e projektit

- Është përgatitur dhe dorëzuar në redaksi një studim me 2500 faqe.
- Janë realizuar dy konferenca shkencore me zbulimet e reja nga projekti. Në to kanë marrë pjesë 20 studiues.
- Nga shfrytëzimi i materialeve arkivore të sjella në kuadrin e këtij projekti janë shkruar edhe shumë artikuj shkencorë individualë dhe referate. Këto materiale kanë qenë pjesë e rëndësishme burimore për shkrimin deri tani të dy monografive shkencore: B. Meta “**Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri, 1912-1924**”, 715 faqe, Tiranë, 2014; Hasan Bello “**Marrëdhëniet shqiptaro-turke 1912-1939**”, 500 faqe, Tiranë, 2014. Në proces janë edhe shumë vepra të tjera monografike, në të cilat dokumentet dhe literatura historiografike e realizuar në kuadrin e këtij projekti po shfrytëzohen gjerësisht.

- Me këto materiale janë përgatitur dhe mbrojtur deri tani shtatë teza doktorate, dhe ato po shfrytëzohen për 30 teza të tjera që janë në proces.
- Rezultatet nga kërkimet janë publikuar edhe në shtypin periodik dhe median televizive.
- I është dhënë një impuls i ri zhvillimit të shkencës historike në trevat shqiptare. Është realizuar një studim me nivel të lartë shkencor me karakter sintetik. Ky studim do të zgjidhë një sërë problemesh shkencore të debatueshme apo të paqarta deri më sot. Njëkohësisht do të shtrojë për zgjidhje një sërë çështjesh të tjera dhe do të hapë horizonte të reja për kërkimin shkencor në fushën e historisë sonë kombëtare në të ardhmen. Janë implementuar metoda të reja e moderne kërkimi dhe të analizës shkencore. Është futur në qarkullim shkencor një informacion i ri dhe burime të reja historike, si dhe teza e hipoteza të reja shkencore për historinë e Shqipërisë:

1. Është shkruar një histori e plotë e shqiptarëve, e cila është bazuar në arritjet më të mira të historiografisë shqiptare dhe të huaj të derisotme, si dhe në kërkime të reja intensive bibliotekare e arkivore që janë kryer enkas për këtë botim.
2. Është përftuar një studim akademik cilësisht më i lartë se botimet aktuale nga pikëpamja e reflektimit të rezultateve të derisotme të shkencës historike.
3. Është përftuar një botim me një gamë të gjerë informacioni shkencor të dorës së parë dhe një pjesë e konsiderueshme e të cilit është e re, që hidhet në qarkullim shkencor për herë të parë.
4. Është kryer një studim ku janë aplikuar metodat më të përparuara shkencore që aplikohen sot edhe nga historiografia më serioze e vendeve perëndimore.
5. Është realizuar një studim me parametra të lartë shkencorë i krahasueshëm me standardet e larta të botimeve akademike në vendet e zhvilluara.
6. Objektiviteti shkencor është shtylla kryesore dhe thelbi i këtij botimi.
7. Studimi ka karakter krahasues dhe polemik ndryshe nga studimet e kryera më parë dhe pasqyron gjithë pikëpamjet e autorëve seriozë për problemet kryesore historiografike të periudhës në studim. Është përftuar një studim me karakter të spikatur polemik ku autorët janë vënë para sprovës së vërtetimit të tezave e konkluzioneve të tyre, pa anashkaluar arritjet dhe pikëpamjet e autorëve të tjerë. Kjo i ka dhënë studimit një karakter serioz dhe e ka bërë atë tepër interesant.

8. Është realizuar një studim me karakter gjithëpërfshirës për sa u përket pikëpamjeve historiografike gjë që do të përbëjë një risi në botimet e deritanishme dhe do të dëshmojë për karakterin korrekt dhe qëndrimin e ndershëm dhe serioz në historiografi.
9. Studimi ka një karakter të spikatur autentik, gjë që do të ndikojë pozitivisht në interesin e lexuesit ndaj tij.
10. Botimi do të ndikojë pozitivisht për mënyrën e të menduarit dhe të të mësuarit në shkollat parauniversitare, në shkollat e larta dhe në studimet pasuniversitare.
11. Studimi do të ndihmojë një sërë studimesh të reja monografike individuale në Institutin e Historisë të Tiranës, të Prishtinës, në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në Universitetin e Tiranës, në uuniversitetet e rretheve, në Universitetin e Prishtinës, të Tetovës etj.
12. Do te japë një kontribut të shquar për universitet shqiptare për të rritur nivelin e mësimdhënies dhe formimin shkencor të studentëve, si dhe përmirësimin e edukimit të tyre atdhetar, qytetar e demokratik.

## 4. REKOMANDIME

Në lidhje me organizimin e punës në këtë projekt u krijua një përvojë e re mjaft e vlefshme prej së cilës burojnë këto rekomandime:

- Kur miratohet një projekt duhet që financimi të jetë i siguruar dhe të realizohet sipas projektit të miratuar.
- Administrimi financiar i projektit, duhet të bëhet nga drejtuesi i tij dhe jo të lihet në dorën e agjencisë ekzekutive, pasi krijohen keqkuptime e vështirësi.

Në lidhje me gjendjen aktuale të projektit rekomandojmë:

- Të bëhet përkthimi i veprës në gjuhën angleze, sikurse është projektuar qysh në fillim.
- Të rekomandohet ajo në studimet universitare e postuniversitare.



- Të shpërndahet ajo në bibliotekat brenda dhe jashtë vendit.
- Materialet arkivore të përftuara nga ky projekt të vijojnë të studiohen intensivisht dhe gjerësisht në të ardhmen për përgatitjen e studimeve monografike, tezave doktorale, mikrotezave, artikujve shkencorë dhe referateve.
- Meqenëse janë marrë në mënyrë të plotë të gjitha koleksionet e dokumenteve që lidhen me historinë tonë kombëtare nga arkivat kryesore të huaja, të nisë një projekt i ri madhor për botimin e korpuseve seriale të dokumenteve nga këto arkiva.

## • **Përfituesit nga projekti**

### **Përfituesit direktë:**

- Studentët e të gjitha universiteteve shqiptare.
- Specialistët e shkencave shoqërore, mësuesit, pedagogët, punonjësit e rinj kërkimor, diplomatët, punonjësit e institucioneve politike e kulturore, masmedia dhe specialistët e saj.
- Studentë dhe studiues të huaj që merren me çështjet shqiptare.

### **Përfituesit indirektë**

- Nxënësit e arsimit parauniversitar, pasi në bazë të këtij botimi do të rishikohen tekstet e shkollave, duke ngritur nivelin e përmbajtjes së tyre.

## 5. A MUND TE SHNDËRROHET PROJEKTI NË IDE BIZNESI OSE A MUND TË SJELLIN PËRFITIME REZULTATET E TIJ?

- *Megjithëse është një projekt i shkencave albanologjike, rezultatet e tij mund të sjellin të ardhura nëpërmjet këtyre rrugëve:*
- Botimi i studimit në gjuhën shqipe dhe tregtimi i tij.
- Botimi i studimit në gjuhë të huaj (fillimisht në anglisht) dhe tregtimi i tij.
- Mediatizimi i botimit dhe i rezultateve të tij.
- Prezantimi i këtyre rezultateve në revista e konferenca prestigjioze ndërkombëtare.
- Shndërrimi i botimit në pjesë të kurrikulave të universiteteve shqiptare dhe të huaja nëpërmjet bashkëpunimit me pedagogë shqiptar dhe të huaj.
- Dërgimi i botimit në bibliotekat dhe libraritë më të rëndësishme të botës nëpërmjet një programi e marketingu të studiuar dhe energjik.